



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1351/7 prot.

Tiranë, më 17.07.2026

REKOMANDIM

Nr. 45, datë 17.07.2026

PËR KONTROLLUESIN, SHOQËRIA “PAYSERA ALBANIA” SHPK

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (në vijim “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Paysera Albania” sh.p.k. (në vijim “Kontrolluesi”),

KONSTATOHET SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 111, datë 18.05.2026, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”), u organizua grupi i punës, i cili kreu hetimin administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “Ligji”), me fokus masat tekniko-organizative për përpunimin e tyre, veçanërisht sistemet e menaxhimit të të dhënave personale (PIMS)”.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të hetimit, procesverbalin e hetimit administrativ dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS M01608007N, me objekt aktiviteti “Emetim të parasë elektronike, shërbimet e pagesave të transferimit të parave, këmbim valutë, shërbime këshilluese etj.”.

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë e të dhënave “punonjës”, “klientë”, “vizitorë” etj. Përpunimi i të dhënave personale kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Konstatohet se Kontrolluesi grumbullon në dosjet e personelit dokumentacionin që përfshin, ndër të tjera, certifikatën familjare të punonjësve, në kundërshtim me

parimin e minimizimit të të dhënave, të parashikuar në pikat 3 dhe 5 të nenit 6 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi, gjatë proceseve përpunuese duhet të vlerësojë përputhshmërinë me parimin e minimizimit të të dhënave, në kuptim të mbledhjes dhe përpunimit vetëm të atyre të dhënave që janë të përshtatshme, përkatëse dhe të domosdoshme në raport me qëllimin e përpunimit. Në këtë kuadër, duhet të analizohet nëse vërtetimi i gjendjes gjyqësore është i justifikuar në çdo rast, pasi jo në të gjitha pozicionet e punës një e tillë është e nevojshme dhe proporcionale.

Gjithashtu, Kontrolluesi në cilësinë e subjektit përgjegjës për përcaktimin e qëllimeve dhe mjeteve të përpunimit të të dhënave personale ka detyrimin të sigurojë që çdo proces përpunimi të jetë në përputhje me parimet themelore të mbrojtjes së të dhënave personale, veçanërisht me parimin e minimizimit të të dhënave, të parashikuar në pikat 3 dhe 5 të nenit 6 të Ligjit. Në zbatim të këtij parimi, Kontrolluesi duhet të garantojë që të dhënat personale të mbledhura dhe të ruajtura të jenë vetëm ato që janë të përshtatshme, të lidhura drejtpërdrejt me qëllimin e përpunimit dhe të kufizuara në masën e nevojshme për realizimin e këtij qëllimi.

Në rastin konkret, Zyra e Komisionerit vlerëson se përfshirja dhe ruajtja e certifikatës familjare në dosjet e personelit përbën një përpunim të të dhënave personale, të cilat nuk rezultojnë të jenë të nevojshme për administrimin e marrëdhënies së punës në mënyrë të përgjithshme. Kontrolluesi duhet të vlerësojë nëse informacioni i përfshirë në certifikatën familjare është realisht i domosdoshëm për një proces të caktuar administrativ, apo nëse qëllimi mund të arrihet përmes mjeteve më pak ndërhyrëse, siç mund të jetë mbledhja vetëm e të dhënave specifike të nevojshme për përmbushjen e një detyrimi të caktuar ligjor, pa administruar dokumentacion të plotë që përmban të dhëna shtesë të personave të tretë (anëtarë të familjes), të cilët nuk janë pjesë e drejtpërdrejtë e marrëdhënies së punës.

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi duhet të kryejë një analizë periodike të kategorive të të dhënave që administron në dosjet e personelit, duke identifikuar për secilën kategori qëllimin specifik të përpunimit, bazën ligjore, periudhën e ruajtjes dhe domosdoshmërinë e vazhimit të mbajtjes së tyre. Mbledhja dhe ruajtja e dokumenteve standarde, pa një lidhje të drejtpërdrejtë me funksionin apo detyrimet e punës, bie ndesh me kërkesën që përpunimi të jetë i kufizuar në atë çka është e nevojshme dhe proporcionale.

3. Konstatohet se Kontrolluesi ka emëruar nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave personale (DPO). Megjithatë, nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se Kontrolluesi nuk ka kryer njoftimin pranë Zyrës së Komisionerit për caktimin e tij, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 34 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se DPO shërben si pikë kontakti zyrtare midis Kontrolluesit, Komisionerit dhe subjekteve të të dhënave, duke lehtësuar komunikimin e shpejtë, bashkëpunimin dhe trajtimin e menjëhershëm të kërkesave, ankesave apo cenimeve të të dhënave. Ky njoftim kontribuon në plotësimin regjistrat

elektronik qendror të DPO-ve, duke siguruar transparencë të plotë dhe duke kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e përputhshmërisë ligjore, parandalimin e shkeljeve dhe shmangien e pasojave të rënda, duke mbrojtur në fund të drejtat dhe liritë themelore të individëve.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit në rrugë postare dhe në formë elektronike.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore, të datës 07.07.2026, të organizuar nga Zyra e Komisionerit, gjatë së cilës ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, si dhe bashkëpunimin me Komisionerin për të siguruar që çdo mangësi të adresohet në përputhje me Ligjin.

Gjithashtu, paraprakisht nga ana e Kontrolluesit, me shkresën nr. 75 prot., datë 06.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1351/6 prot., datë 07.07.2026, janë përcjellë me relacion shpjegues të gjitha masat e marra në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 34, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit, Komisioneri,

REKOMANDON:

1. Kontrolluesi, shoqëria "Paysera Albania" sh.p.k., të ketë në vëmendje rishikimin e procedurave të mbledhjes dhe administrimit të të dhënave personale të personelit, me qëllim garantimin se përpunohen vetëm ato të dhëna që janë të përshtatshme, përkatëse dhe të domosdoshme për qëllimin e përcaktuar të përpunimit, duke eliminuar mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave të tepërta, në zbatim të parimit të minimizimit të të dhënave, në përputhje me kërkesat e nenit 6 të Ligjit;
2. Kontrolluesi, shoqëria "Paysera Albania" sh.p.k., të marrë masa lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, si dhe për njoftimin e caktimit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale pranë Zyrës së Komisionerit, sipas parashikimeve të nenit 34 të Ligjit;

3. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
- i) vazhdimisht, detyrimin e përcaktuar në pikën 1 më sipër;
 - ii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 2 më sipër;
- Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.
4. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve;
5. Komisioneri, bazuar në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me Ligjin. Në rast të moszbatimit të tyre, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 17.07.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi